

VENDIM
Nr. 60, datë 28.5.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Asim Vokshi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 20.5.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 19 (S) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Sanie Metushi, Dudi Shabani (Metushi), përfaqësuar nga avokati Toto Avdiaj, me prokurorë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koça.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 62-2022-2874 (789), datë 8.7.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. 97, datë 11.10.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2025-553, datë 2.4.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1, i Protokollit nr. 12 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueseve Sanie Metushi dhe Dudi Shabani (Metushi) (*kërkueset*), të cilat kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkueset janë nëna dhe motra e shtetasit B. M. (*viktima*), i cili kishte emigruar në mënyrë të parregullt në Greqi dhe, për një periudhë kohe, kishte qëndruar në fshatin Nikea të Larisës. Në datën 25.9.1996, në një arë të këtij fshati, një shtetas grek e ka gjetur viktimën të vranë dhe ka njoftuar menjëherë policinë. Sipas aktit të ekspertimit mjeko-ligjor të datës 26.9.1996, viktima ka pasur një plagë prerëse dhe një dëmtim thërrmues të kockës së pjesës së sipërme të kokës, të shkaktuar me një levë hekuri, ndërsa janë gjetur shenja gjaku dhe fije floku me gjatësi 20 cm. Viktima është identifikuar nga xhaxhai i tij, shtetasi P. M., dy ditë më pas, në datën 27.9.1996. Për këtë ngjarje janë regjistruar procedime penale si nga autoritetet greke, ashtu edhe nga autoritetet shqiptare.

2. Autoritetet greke kanë regjistruar procedim penal për veprat penale të vrasjes me paramendim dhe të përdorimit të armës, të parashikuara nga neni 299, paragrafi 1, i Kodit Penal të Greqisë dhe neni 14, i ligjit nr. 2168/93. Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, prokurori i Gjykatës së Shkallës së Parë të Larisës, me vendimin e datës 10.3.1999, ka vendosur arkivimin e çështjes në arshivën e çështjeve me autorë të panjohur.

3. Procedimi penal nga autoritetet shqiptare ka filluar mbi bazën e kallëzimit penal të datës 28.11.1996, të bërë nga xhaxhai i viktimës, në të cilin ai ka dhënë të dhëna për autorët e mundshëm të krimit dhe për motivin e mundshëm të krimit, konkretisht përvetësimin e një shume parash. Në datën 29.11.1996, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier (*Prokuroria e Fierit*) ka regjistruar procedimin penal nr. 502 (procedimi nr. 502/1996) për veprën penale “Vrasja me dashje”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 76 dhe 25 të Kodit Penal (KP).

4. Në kuadër të këtij procedimi penal, me urdhër të prokurorit, janë ndaluar shtetasit F. A., A. M. dhe M. T., me të cilët viktimja kishte qëndruar në Greqi dhe që, sipas xhaxhait të viktimës, ishin autorë të mundshëm të vrasjes së tij. Për këta shtetas, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e datës 1.12.1996, ka caktuar masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, me afat një muaj. Po ashtu, gjatë hetimeve paraprake, në muajt nëntor–dhjetor 1996, Prokuroria e Fierit, krahas deklarimeve të këtyre shtetasve të dyshuar, ka marrë deklarime edhe nga shtetas të tjerë, të përmendur nga kallëzuesi si persona që kishin dijeni për rrethanat e ngjarjes. Në vijim, me vendimin e datës 25.3.2001, Prokuroria e Fierit ka vendosur pezullimin e hetimeve, me arsyetimin se, sipas saj, nuk ishte zbuluar autori ose autorët e veprës penale, duke iu kërkuar strukturave të Policisë së Qarkut Fier kryerjen e veprimeve për zbulimin e tyre.

5. Në datën 13.5.2009, Prokuroria e Fierit, në zbatim të konventës evropiane “Mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale”, u ka kërkuar autoriteteve greke të drejtësisë konfirmimin e ekzistencës së faktit penal, informacion nëse ishte ushtruar ndjekje penale në atë shtet dhe për personat e dyshuar, si dhe, nëse ekzistonte procedim penal ndaj shtetasve shqiptarë, transferimin e tij ose vënien në dispozicion të akteve përkatëse. Në përgjigje, në datën 4.8.2009, autoritetet greke të drejtësisë kanë dërguar aktet e procedimit penal të regjistruar në atë shtet.

6. Mbi bazën e materialeve të dërguara nga autoritetet greke të drejtësisë, Prokuroria e Fierit, me vendimin e datës 1.9.2009, ka shfuqizuar vendimin e pezullimit të hetimeve, duke i rifilluar ato. Megjithatë, me vendimin e datës 28.10.2009, Prokuroria e Fierit ka vendosur sërish pezullimin e hetimeve, për të njëjtin shkak. Ky vendim është revokuar në datën 27.1.2017 dhe po në këtë datë, Prokuroria e Fierit ka vendosur pushimin e procedimit penal, bazuar në nenin 328, shkronja “d”, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), me arsyetimin se ndjekja penale ishte parashkruar sipas nenit 66 të KP-së. Në dispozitivin e vendimit, prokurori ka urdhëruar që vendimi t’u njoftohet personave që kishin bërë kallëzimin penal. Megjithatë, në fashikullin e hetimit nuk rezulton ndonjë akt që të provojë dërgimin dhe marrjen e njoftimit nga kallëzuesi ose nga familjarë të tjerë të viktimës, përfshirë edhe kërkueset.

7. Gjatë viteve 2019–2022 babai i viktimës dhe avokatë të caktuar nga ai me prokurë i janë drejtuar disa herë Prokurorisë së Fierit, por edhe Prokurorisë së Përgjithshme, fillimisht me kërkesa për informacion lidhur me gjendjen e procedimit dhe, në vijim, edhe për vënien në dispozicion të kopjeve të njësuara të akteve të dosjes hetimore. Në përgjigje të këtyre kërkesave, Prokuroria e Fierit, përmes disa shkresave, ka informuar babanë e viktimës se informacioni për çështjen dhe aktet e hetimit i ishin vënë në dispozicion avokatit A. K., i cili kishte nënshkruar kërkesën e datës 23.12.2019. Megjithatë, në dosjen e hetimit nuk ka konfirmim për marrjen e këtyre shkresave nga babai i viktimës. Kërkesa e fundit, e nënshkruar nga babai i viktimës dhe avokati me prokurë T. A., mban datën 1.6.2022. Në fund të saj gjendet shënimi me shkrim dore i avokatit T. A. me këtë përmbajtje: “*Mora një kopje të akteve, sipas kërkesës, sot në datën 3.6.2022.*”. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, babai i viktimës i është drejtuar edhe autoriteteve greke me kërkesë për informacion në lidhje me çështjen penale. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit në Larisa në datën 19.7.2021 e

ka informuar se për të marrë informacion për ecurinë e çështjes duhej të dërgohej letërporosi nga autoritetet kompetente shqiptare.

8. Në datën 13.6.2022, duke pretenduar se me vendimin e prokurorit për pushimin e çështjes janë njohur në datën 3.6.2022, kërkuaset kanë paraqitur ankim në gjykatë, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit dhe vazhdimin e hetimeve. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2022-2874 (789) datë 8.7.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të pushimit të procedimit penal. Në mënyrë të përmbledhur, gjykata ka arsyetuar se ankimi kundër vendimit të pushimit të procedimit penal është paraqitur jashtë afatit 10-ditor sipas nenit 329, pika 1, të KPP-së. Sipas gjykatës, vendimi i pushimit i është njoftuar babait të viktimës me shkresën nr. 258/1 prot., datë 15.1.2021, sipas së cilës kopjet e akteve janë marrë nga avokati A. K. Po sipas gjykatës, edhe me shkresën nr. 181/1 prot., datë 20.2.2020, avokati i caktuar nga babai i viktimës është informuar për mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sikundër ai është informuar edhe me shkresën nr. 130/1 prot., datë 14.12.2020. Megjithëse e ka konsideruar ankimin të paraqitur jashtë afatit, gjykata ka shqyrtuar edhe ligjshmërinë e vendimit të pushimit, duke vlerësuar se ndjekja penale ishte parashkruar sipas nenit 66, shkronja “a”, të KP-së, sipas përmbajtjes së tij përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 36, datë 30.3.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’”, të ndryshuar, si dispozita më e favorshme. Sipas saj, nga koha e kryerjes së veprës penale, e përcaktuar si data 21.9.1996, deri në çastin e pushimit të procedimit penal, në datën 27.1.2017, kishin kaluar 20 vjet. Kërkuaset kanë paraqitur ankim kundër këtij vendimi.

9. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 97, datë 11.10.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Edhe gjykata e apelit e ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e kërkueseve për mungesën e njoftimit të vendimit të pushimit të procedimit penal, pasi, sipas saj, ky vendim i ishte njoftuar babait të viktimës me shkresën nr. 130/1 prot., datë 14.12.2020. Megjithatë, ajo ka shqyrtuar edhe pretendimet për ligjshmërinë e vendimit të pushimit të procedimit penal, duke e vlerësuar atë të drejtë dhe duke arritur në të njëjtin përfundim se ndjekja penale ishte parashkruar. Në arsyetimin e saj gjykata e apelit ka parashtruar se vendosja e afateve të parashkrimit nga ligjvënësi është shprehje e parimit të sigurisë juridike, pasi individit nuk mund të mbahet për një kohë të pacaktuar në pasiguri për ushtrimin ndaj tij të ndjekjes penale. Ajo ka vlerësuar se parashkrimi është edhe shprehje e parimit të humanizmit, pasi, pas kalimit të një kohe të gjatë pa u dënuar, dënimi i mëvonshëm i një personi që ka treguar se është risocializuar mund të mos përmbushë më qëllimet e dënimit. Po kështu, sipas gjykatës së apelit, kalimi i një kohe të gjatë mund të dëmtojë procesin gjyqësor për shkak të vështirësive në administrimin e provave. Gjykata e apelit ka vlerësuar se prokuroria kishte vendosur me të drejtë pushimin e procedimit penal, pasi kryerja e mëtejshme e hetimeve nuk do të sillte rezultat, për sa kohë procedimi nuk mund të vazhdonte. Kundër këtij vendimi kërkuaset kanë paraqitur rekurs.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-553, datë 2.4.2025, pasi ka shqyrtuar rekursin në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se shkaqet e parashtruara nuk përfshiheshin në ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, neni 66 i KP-së nuk kishte pësuar ndryshime në periudhën nga kryerja e veprës penale deri në marrjen e vendimit nga prokurori për pushimin e çështjes, ndaj vendimi i prokurorit ishte i drejtë, sikurse kishin konkluduar edhe gjykatat më të ulëta. Për mosnjoftimin e vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit, Kolegji Penal ka vlerësuar se gjykatat e faktit e kishin gjetur me të drejtë këtë pretendim të pabazuar.

11. Në datën 1.7.2025, kërkuaset, nëpërmjet shërbimit postar, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual me objektin e pasqyruar në pjesën hyrëse të vendimit. Ky ankim, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 9.7.2025. Kolegji i Gjykatës, në datën 22.10.2025, pas shqyrtimit paraprak të kërkesës, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazën e dokumenteve.

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkueset**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

12.1 *E drejta për t'u njoftuar*, pasi vendimi i prokurorisë për pushimin e procedimit penal nuk është komunikuar asnjëherë. Ato janë njohur me këtë vendim në datën 3.6.2022, kur avokati ka tërhequr një kopje të akteve të dosjes. Pavarësisht se në dosje gjenden shkresa përmes të cilave pretendohet se familjarët e viktimës janë informuar për mënyrën e përfundimit të procedimit penal, në të vërtetë ata nuk kanë marrë asnjë njoftim. Madje nuk rezulton që këto shkresa të jenë dërguar ose dorëzuar përmes shërbimit postar.

12.2 *E drejta për t'u dëgjuar*, pasi Gjykata e Apelit Vlorë ka shkelur nenin 426/a të KPP-së, për sa i përket shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit.

12.3. *E drejta për jetën*, e garantuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së, për shkak të mungesës së një hetimi të plotë dhe efektiv për vdekjen e familjarit të tyre. Prokuroria nuk ka kryer veprime hetimore të nevojshme për zbardhjen e ngjarjes. Në veçanti, ajo duhej t'u kërkonte autoriteteve greke vënien në dispozicion të provave materiale të gjetura dhe të sekuestruara në vendin e ngjarjes, përfshirë levën e hekurit dhe fijet e flokut, si dhe kryerjen e ekspertimeve të nevojshme për gjurmët e gishtave. Megjithatë, autoriteteve greke nuk u është drejtuar asnjë kërkesë për marrjen e këtyre provave ose për kryerjen e ekspertimeve përkatëse. Prokuroria e ka lënë procedimin për periudha të gjata pa kryer veprime hetimore, derisa është plotësuar afati i parashkrimit të ndjekjes penale. Familjarët e viktimës kishin treguar edhe emrat e tre personave të dyshuar si autorë të mundshëm të krimit, të cilët fillimisht janë ndaluar dhe më pas janë liruar për mungesë provash, pa u kryer veprimet e nevojshme për sigurimin e provave të administruara nga autoritetet greke. Prokuroria i është referuar qëllimisht nenit 76 të KP-së "*Vrasja me dashje*", me qëllim zbatimin e një afati më të shkurtër parashkrimi dhe favorizimin e autorëve të mundshëm të ngjarjes, ndonëse këta persona ishin kallëzuar konkretisht nga familjarët e viktimës. Për sa kohë në dosje nuk kishte të dhëna të mjaftueshme për rrethanat dhe motivet e krimit, prokuroria nuk mund ta cilësonte veprën penale si "*Vrasja me dashje*". Rrethanat e ngjarjes, përfshirë marrjen e shumës së parave që viktimë kishte me vete, tregonin se ai ishte vrarë me paramendim. Për rrjedhojë, prokuroria dhe policia duhet të kryenin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore për përcaktimin e rrethanave të veprës penale dhe identifikimin e autorit ose autorëve të saj. Veprimet dhe mosveprimet e prokurorisë u kanë shkaktuar familjarëve të viktimës një dëm të pallogaritshëm, ndërsa ata nuk kanë marrë asnjëherë përgjigje për rrethanat e vdekjes së tij dhe autorët e mundshëm. Për më tepër, Gjykata e Lartë e ka trajtuar rastin si çështje të interpretimit të ligjit dhe vlerësimit të provave, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve për mungesën e një hetimi efektiv.

13. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka prapësuar:

13.1 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u njoftuar* nuk është i bazuar, pasi vendimi i prokurorit për pushimin e procedimit penal i është komunikuar babait të viktimës. Sipas shkresës nr. 258/1 prot., datë 15.1.2021, të Prokurorisë së Fierit, në datën 17.1.2020 avokati A. K. ka marrë kopjet e akteve. Nga kjo shkresë rezulton edhe se Prokurorisë së Fierit i ishin drejtuar për informacion edhe avokatët B. C. e A. S. të studios ligjore "A.", si dhe babai i viktimës. Ata ishin informuar për mënyrën e zgjidhjes së çështjes me shkresat nr. 181/1 prot., datë 20.2.2020 dhe nr. 130/1 prot., datë 14.12.2020, të kësaj prokurorie. Për më tepër, ankimi ndaj vendimit të prokurorit është paraqitur jashtë afatit ligjor, sikurse kanë konstatuar edhe gjykatat e faktit. Pavarësisht këtij konstatimi, gjykatat kanë shqyrtuar dhe kanë arsyetuar në mënyrë shteruese për themelin e pretendimeve të kërkueseve.

13.2 Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës për jetën* në aspektin procedural, kërkueset nuk kanë parashtruar argumente në nivel kushtetues. Pretendimet e tyre kanë të bëjnë me vlerësimin e provave nga prokuroria dhe gjykatat e zakonshme, me cilësimin juridik të veprës penale dhe me ligjshmërinë e vendimit për pushimin e procedimit penal. Vendimet e gjykatave të zakonshme janë rezultat i një analize të plotë e të hollësishme të rrethanave të ngjarjes dhe provave të shqyrtuara. Për më tepër, ankimi ndaj vendimit të prokurorit është

paraqitur jashtë afatit ligjor, ndaj kërkueset kanë humbur mundësinë për të ushtruar në mënyrë efektive mjetin juridik të parashikuar nga ligji për kundërshtimin e këtij vendimi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueseve

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhen me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Në këtë këndvështrim, kërkueset legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi, në cilësinë e familjareve të afërta të viktimës së veprës penale, përkatësisht nënës dhe motrës së tij, kanë qenë palë në procesin gjyqësor të zhvilluar për kundërshtimin e vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal. Pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues individual lidhen me këtë proces dhe me detyrimin procedural të autoriteteve shtetërore për hetimin e vdekjes së familjarit të tyre. Për rrjedhojë, ato provojnë interesin e drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar si viktimë të tërthorta të shkeljeve kushtetuese të pretenduara.

16. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike*, Gjykata ka pohuar se ai nënkupton jo vetëm që individit t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata verifikon nëse kërkueset i kanë ngritur paraprakisht përpara gjykatave të zakonshme pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual dhe nëse kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion.

17. Fillimisht, Gjykata vëren se, në parashtrimet e datës 26.11.2025, kërkueset kanë pretenduar cenimin e *së drejtës për t’u dëgjuar*, pasi Gjykata e Apelit Vlorë ka shkelur nenin 426/a të KPP-së për sa i përket shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit. Gjykata konstaton se kërkueset nuk e kanë ngritur këtë pretendim në rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë, por e kanë paraqitur atë për herë të parë në parashtrimet e sipërpërmendura. Për rrjedhojë, për këtë pretendim nuk plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike. Po kështu, Gjykata vëren se ky pretendim përbën një shkak të ri të ankimit kushtetues individual dhe është paraqitur pas vendimit të Kolegjit për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Sipas jurisprudencës kushtetuese, pretendimet e reja që përbëjnë shtesë të shkaqeve të ankimit kushtetues individual nuk mund të merren në shqyrtim kur paraqiten pas këtij momenti, pasi ato duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme të formës dhe të afatit dhe t’i nënshtrohen procedurës së shqyrtimit paraprak (*shih vendimet nr. 40, datë 26.3.2026; nr. 21, datë 22.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim edhe për këtë shkak.

18. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata vëren se kërkueset kanë ushtruar ankim dhe rekurs kundër vendimeve të gjykatave të zakonshme. Ndonëse gjykatat e faktit e kanë konsideruar ankimin ndaj vendimit të prokurorit të paraqitur jashtë afatit ligjor, ato nuk janë kufizuar në këtë konstatim, por kanë shqyrtuar edhe pretendimet për ligjshmërinë e vendimit të pushimit të procedimit penal. Kërkueset i kanë parashtruar edhe në rekurs pretendimet për mungesën e njoftimit dhe mungesën e një hetimi të plotë e efektiv. Për rrjedhojë, për këto pretendime, kërkueset i kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion. Ndërsa për sa u përket

pretendimeve që lidhen me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, i vetmi mjet juridik në dispozicion të tyre është ankimi kushtetues individual.

19. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës parashikon afatin ligjor prej 4 muajsh nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret, vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 2.4.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë nëpërmjet shërbimit postar në datën 1.7.2025, pra brenda afatit ligjor. Për rrjedhojë, kërkeset legjitimohen *ratione temporis* për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

20. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkeset kanë parashtruar pretendime për: i. *cenimin e së drejtës për t’u njoftuar* për vendimin e prokurorit për pushimin e procedimit penal, pretendim që lidhet, në thelb, me *të drejtën e aksesit në gjykatë*; ii. *cenimin e së drejtës për jetën* në aspektin procedural, për shkak të *mungesës së një hetimi të plotë dhe efektiv* për vdekjen e familjarit të tyre. Këto pretendime hyjnë në juridiksionin kushtetues dhe do të shqyrtohen në vijim.

21. Gjykata, duke mbajtur parasysh se argumentet e kërkueseve janë të ndërlidhura dhe kanë të bëjnë me kontrollin gjyqësor të vendimit për pushimin e procedimit penal, veçanërisht me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, çmon ta shqyrtojë pretendimin për mungesën e njoftimit në këndvështrim të *së drejtës së aksesit në gjykatë*, ndërsa pretendimin për mungesën e përgjigjes ndaj argumenteve për efektivitetin e hetimit në këndvështrim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* të lidhur me *aspektin procedural të së drejtës për jetën*. E drejta e aksesit dhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor janë aspekte të procesit të rregullt ligjor, të garantuara nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se të drejtat e njohura nga Kushtetuta, përfshirë të drejtën për jetën, nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

22. Lidhur me *të drejtën për jetën*, Gjykata evidenton se neni 21 i Kushtetutës parashikon se jeta e personit mbrohet me ligj. Gjykata ka pohuar se njeriu dhe jeta e tij janë vlerat më superiore për shtetin dhe se kjo e drejtë qëndron në themel të të gjitha të drejtave, pasi mohimi i saj sjell edhe eliminimin e të drejtave të tjera njerëzore (*shih vendimet nr. 42, datë 29.5.2024; nr. 65, datë 10.12.1999, të Gjykatës Kushtetuese*). Në aspektin procedural, kjo e drejtë kërkon nga autoritetet shtetërore kompetente kryerjen e një hetimi efektiv. Ky nuk është një detyrim për arritjen e rezultatit, por për përdorimin e mjeteve, ndërsa hetimi duhet të jetë në gjendje të përcaktojë faktet dhe, sipas rastit, të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës (*shih vendimin nr. 42, datë 29.5.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimet e kërkueseve për mungesën e një hetimi të plotë dhe efektiv kanë qenë objekt i një kontrolli gjyqësor efektiv dhe kanë marrë një përgjigje në përputhje me standardet kushtetuese të *aksesit në gjykatë dhe të arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të lidhura me aspektin procedural të së drejtës për jetën

23. Kërkeset kanë pretenduar se vendimi i prokurorit për pushimin e procedimit penal nuk u është njoftuar dhe se ato janë njohur me të vetëm në datën 3.6.2022, kur avokati ka tërhequr një kopje të akteve të dosjes. Sipas tyre, në dosje nuk ka prova që shkresat, përmes të cilave pretendohet se familjarët e viktimës janë informuar për përfundimin e procedimit penal, të jenë dërguar ose dorëzuar përmes shërbimit postar. Për rrjedhojë, konstatimi i gjykatave se ankimi ishte paraqitur jashtë afatit ligjor u ka cenuar aksesin në gjykatë. Kërkeset kanë pretenduar, gjithashtu, se nuk është kryer një hetim i plotë dhe efektiv për vdekjen e familjarit të tyre dhe se ato nuk kanë marrë përgjigje për rrethanat e ngjarjes dhe autorin ose autorët e mundshëm. Sipas tyre, prokuroria nuk u ka kërkuar autoriteteve greke vënien në dispozicion të provave materiale të administruara në vendin e ngjarjes dhe kryerjen e ekspertimeve të nevojshme, si dhe e ka lënë procedimin për periudha të gjata pa veprime hetimore, deri në plotësimin e afatit të parashkrimit, ndonëse familjarët e viktimës kishin treguar konkretisht tre persona si autorë të mundshëm të krimit. Po sipas kërkueseve, prokuroria i është referuar qëllimisht nenit 76 të

KP-së për veprën penale “Vrasja me dashje”, me qëllim zbatimin e një afati më të shkurtër parashkrimi dhe favorizimin e autorëve të mundshëm, ndërsa rrethanat e pretenduara të ngjarjes dhe motivi pasuror tregonin se viktimë ishte vrarë me paramendim. Për më tepër, Gjykata e Lartë e ka trajtuar rastin si çështje të interpretimit të ligjit dhe vlerësimit të provave, pa u dhënë, në vendimin e saj, përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs për mungesën e një hetimi të plotë dhe efektiv, të cilat, sipas tyre, kishin natyrë kushtetuese.

24. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se pretendimet e kërkueseve janë të pabazuara. Sipas tij, vendimi i prokurorit për pushimin e procedimit penal i është komunikuar babait të viktimës, ndërsa avokati i caktuar prej tij ka marrë edhe kopjet e akteve të dosjes. Për rrjedhojë, ankimi ndaj këtij vendimi është paraqitur jashtë afatit ligjor, sikurse kanë konstatuar gjykatat e faktit, të cilat, pavarësisht këtij konstatimi, kanë shqyrtuar edhe ligjshmërinë e vendimit të pushimit. Për sa i përket aspektit procedural të së drejtës për jetën, kërkueset nuk kanë parashtruar argumente në nivel kushtetues, pasi pretendimet e tyre kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, cilësimin juridik të veprës penale dhe ligjshmërinë e vendimit të prokurorit, çështje që u përkasin autoriteteve të ndjekjes penale dhe gjykatave të zakonshme. Sipas subjektit të interesuar, këto gjykata kanë analizuar në mënyrë të plotë rrethanat e ngjarjes dhe provat e marra në shqyrtim.

25. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit në gjykatë, përfshirë të drejtën për ta vënë atë në lëvizje, përbën një aspekt të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 62, datë 23.10.2025; nr. 12, datë 28.2.2024; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të marrë nga gjykata një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 11, datë 11.2.2026; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. E drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, të garantuar nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyeimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i tij është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 10.4.2025; nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se detyrimi për arsyetimin e vendimit gjyqësor nuk nënkupton se gjykatat duhet t’i japin përgjigje të hollësishme çdo argumenti të palëve dhe se arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë në vendimet e mospranimit të rekursit, në parim, nuk cenon standardin kushtetues. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, duhet t’i shqyrtojë ato dhe të mbajë një qëndrim të shprehur në lidhje me to (*shih vendimet nr. 27, datë 29.4.2025; nr. 58, datë 13.11.2023; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata ripohon se u përket gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllime të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e Gjykatës është të kontrollojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë haptazi ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 10, datë 13.3.2025; nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 20, datë 21.6.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyr kur gabimi ligjor ose faktik i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë (*shih vendimet nr. 36, datë 19.3.2026; nr. 4, datë 31.1.2024; nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në këndvështrim të këtyre standardeve kushtetuese dhe të pretendimeve të parashtruara nga kërkueset, Gjykata çmon se kontrolli kushtetues në rastin konkret duhet të zhvillohet në

dy drejtime. *Së pari*, ajo do të vlerësojë nëse mungesa e pretenduar e njoftimit të vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal i ka penguar kërkueset të kenë akses efektiv në gjykatë. *Së dyti*, do të verifikojë nëse pretendimet e ngritura në rekurs për mungesën e një hetimi të plotë dhe efektiv kishin natyrë kushtetuese dhe, nëse po, nëse Gjykata e Lartë u ka dhënë një përgjigje në përputhje me standardin kushtetues të arsytimit. Ky kontroll nuk nënkupton që Gjykata të përcaktojë cilësimin juridik të veprës penale, veprimet konkrete hetimore që duhej të kryheshin ose nëse hetimi ka qenë efektiv. Këto çështje u përkasin autoriteteve të ndjekjes penale dhe gjykatave të zakonshme, sipas kompetencave të tyre, ndërsa Gjykata e Lartë duhet të verifikojë nëse pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në lidhje me to kanë marrë përgjigje në përputhje me standardet kushtetuese, në respektim të parimit të subsidiaritetit.

29. *Për sa i përket pretendimit për mungesën e njoftimit të vendimit për pushimin e procedimit penal*, Gjykata vëren se në fashikullin e hetimit nuk rezulton ndonjë akt që të provojë dërgimin dhe marrjen e këtij vendimi nga kallëzuesi ose familjarët e viktimës. Gjykatat e faktit e kanë lidhur marrjen dijeni të këtij vendimi me shkresat e Prokurorisë së Fierit dhe me faktin se avokatëve të caktuar nga babai i viktimës u ishin vënë në dispozicion akte të dosjes. Mbi këtë bazë, ato e kanë konsideruar ankimin e kërkueseve të paraqitur jashtë afatit ligjor. Megjithatë, Gjykata konstaton se gjykatat e faktit nuk janë kufizuar në konstatimin e paraqitjes së ankimit jashtë afatit, por kanë shqyrtuar edhe ligjshmërinë e vendimit për pushimin e procedimit penal. Gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë analizuar zbatimin e nenit 66 të KP-së dhe kanë arritur në përfundimin se ndjekja penale ishte parashkruar. Kërkueset kanë ushtruar më pas edhe rekurs, për të cilin Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij. Për rrjedhojë, pavarësisht paqartësive për mënyrën e njoftimit dhe momentin e marrjes dijeni për vendimin e pushimit të procedimit penal, nuk rezulton se konstatimi për paraqitjen me vonesë të ankimit i ka penguar kërkueset ta kundërshtojnë vendimin e prokurorit ose se gjykatat kanë refuzuar shqyrtimin gjyqësor të ligjshmërisë së tij vetëm për shkak të paraqitjes së ankimit jashtë afatit. Në këto kushte, pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë për shkak të mungesës së njoftimit të vendimit për pushimin e procedimit penal nuk është i bazuar.

30. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruara nga kërkueset në rekurs nuk kufizoheshin në kundërshtimin e vlerësimit të provave ose të cilësimit juridik të veprës penale. Ato kishin ngritur edhe çështjen e mungesës së një hetimi të plotë dhe efektiv për vdekjen e familjarit të tyre, duke iu referuar konkretisht periudhave të gjata pa veprime hetimore, faktit se prokuroria nuk u kishte kërkuar autoriteteve greke as vënien në dispozicion të provave materiale të administruara prej tyre, as kryerjen e ekspertimeve përkatëse, si dhe mosndjekjes së linjave konkrete të hetimit që lidheshin me personat e treguar si autorë të mundshëm. Po kështu, ato kishin pretenduar se mënyra e cilësimit juridik të veprës kishte ndikuar drejtpërdrejt në afatin e parashkrimit të ndjekjes penale. Për nga përmbajtja, këto argumente vinin në diskutim përmbushjen e detyrimit procedural që buron nga e drejta për jetën dhe, për rrjedhojë, kishin natyrë kushtetuese.

31. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se gjykatat e faktit, ndonëse kanë shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të pushimit të procedimit penal, ato e kanë përqendruar analizën e tyre në zbatimin e nenit 66 të KP-së dhe në qëllimet e institutit të parashkrimit. Nga përmbajtja e vendimeve të tyre rezulton se analiza nuk është shtrirë në mënyrë të veçantë të pretendimet e kërkueseve për zhvillimin e hetimit në raport me aspektin procedural të së drejtës për jetën. Në veçanti, nuk rezulton të jetë vlerësuar nëse, përpara plotësimit të afatit të parashkrimit, autoritetet e ndjekjes penale kishin vepruar me kujdesin e duhur dhe pa vonesa të pajustificuara, nëse ishin ndjekur linjat konkrete të hetimit që mund të ndikonin në zbardhjen e ngjarjes dhe nëse periudhat e mosveprimit ose moskryerja e veprimeve hetimore të pretenduara kishin ndikuar në mundësinë e zbardhjes së saj. Gjykata ka theksuar se kur ngrihet një pretendim për efektivitetin e hetimit në lidhje me të drejtën për jetën, vetëm konstatimi i parashkrimit të ndjekjes penale nuk përbën përgjigje të mjaftueshme ndaj tij (*shih vendimin nr. 42, datë 29.5.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto rrethana, pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs

kërkonin që Gjykata e Lartë të verifikonte nëse ato kishin marrë përgjigjen e nevojshme nga gjykatat më të ulëta.

32. Nga përmbajtja e vendimit të kundërshtuar, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se shkaqet e rekursit nuk përfshiheshin në ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Në arsyetimin e tij ai është përqendruar në zbatimin e nenit 66 të KP-së dhe në pretendimin për mungesën e njoftimit të vendimit të prokurorit. Megjithatë, ndonëse në rekurs ishin parashtruar argumente konkrete për kohëzgjatjen dhe mangësitë e pretenduara të hetimit, Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar natyrën e tyre kushtetuese dhe as nuk ka analizuar nëse gjykatat më të ulëta u kishin dhënë përgjigje në raport me aspektin procedural të së drejtës për jetën. Në veçanti, ajo nuk ka shpjeguar përse argumentet që vinin në diskutim përmbushjen e detyrimit procedural që buron nga e drejta për jetën nuk kërkonin një përgjigje të shprehur në kuadër të shqyrtimit të rekursit. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë nuk ka siguruar një kontroll gjyqësor efektiv të pretendimit me natyrë kushtetuese të ngritur nga kërkueset dhe nuk ka përmbushur standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Fakti se procedimi penal ishte pushuar për shkak të parashkrimit nuk e përjashtonte detyrimin e saj për të verifikuar nëse pretendimet për mënyrën e zhvillimit të hetimit kishin marrë një përgjigje në përputhje me standardet kushtetuese. Për rrjedhojë, për këtë pretendim, aksesit i kërkueseve në Gjykatën e Lartë ka mbetur formal, duke cenuar të drejtën e tyre për proces të rregullt ligjor në drejtim të aksesit substancial dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të lidhura me aspektin procedural të së drejtës për jetën.

33. Në këtë pikë, Gjykata çmon të theksojë se ky përfundim nuk nënkupton vlerësimin prej saj nëse hetimi ka qenë efektiv, se vepra penale duhej të kishte një cilësim juridik të ndryshëm ose se ndjekja penale nuk ishte parashkruar. Shqyrtimi i këtyre çështjeve u përket autoriteteve të ndjekjes penale dhe gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, sipas kompetencave të tyre. Në këtë fazë, i takon Gjykatës së Lartë, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, t'u japë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs. Për këtë arsye, pasojat e cenimit të konstatuar mund të riparohen përmes shfuqizimit të vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë dhe dërgimit të çështjes për shqyrtim në atë gjykatë.

34. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkueseve për cenimin e *së drejtës së aksesit në gjykatë*, në aspektin substancial, dhe *të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, të lidhura me *aspektin procedural të së drejtës për jetën*, është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-553, datë 2.4.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 28.5.2026.

Shpallur më 20.7.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji (kundër)

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini

Anëtarë kundër: Genti Ibrahim, Asim Vokshi

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes që i përket kërkesës së kërkuueseve Sanie Metushi, Dudi Shabani (Metushi), me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 62-2022-2874 (789), datë 8.7.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. 97, datë 11.10.2022, të Gjykatës së Apelit Vlorë; 00-2025-553, datë 2.4.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën, ne, gjyqtarët Fiona Papajorgji, Genti Ibrahimimi dhe Asim Vokshi, jemi kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës, për arsyet e mëposhtme.

2. Shumica vendosi shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, pasi konstatoi se “[...] ndonëse në rekurs ishin parashtruar argumente konkrete për kohëzgjatjen dhe mangësitë e pretenduara të hetimit, Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar natyrën e tyre kushtetuese dhe as nuk ka analizuar nëse gjykatat më të ulëta u kishin dhënë përgjigje në raport me aspektin procedural të së drejtës për jetën. Në veçanti, ajo nuk ka shpjeguar se përse argumentet që vinin në diskutim përmbushjen e detyrimit procedural që buron nga e drejta për jetën nuk kërkonin një përgjigje të shprehur në kuadër të shqyrtimit të rekursit. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë nuk ka siguruar një kontroll gjyqësor efektiv të pretendimit me natyrë kushtetuese të ngritur nga kërkuueset dhe nuk ka përmbushur standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Fakti se procedimi penal ishte pushuar për shkak të parashkrimit nuk e përjashtonte detyrimin e saj për të verifikuar nëse pretendimet për mënyrën e zhvillimit të hetimit kishin marrë një përgjigje në përputhje me standardet kushtetuese. Për rrjedhojë, për këtë pretendim, aksesit i kërkuueseve në Gjykatën e Lartë ka mbetur formal, duke cenuar të drejtën e tyre për proces të rregullt ligjor në drejtim të aksesit substancial dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të lidhura me aspektin procedural të së drejtës për jetën”.

3. Pakica, ndonëse ndan të njëjtin vlerësim me shumicën për sa i përket rëndësisë të së drejtës për jetën në planin kushtetues dhe faktit se ajo përbën bazën e ekzistencës të të gjitha të drejtave të tjera të njeriut, lidhur me çështjen konkrete dhe objektin e gjykimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, vlerëson se jo çdo “gabim” procedural justifikon cenimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Vetëm gabimet procedurale që passjellin njëkohësisht dëmtimin serioz edhe të një të drejte substancial kushtetuese mund të passjellin cenimin e vendimmarrjes së atyre gjykatave.

4. Rasti penal i trajtuar nga gjykatat e zakonshme kishte për objekt: “Kundërshtimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr.502, datë 27.1.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier” dhe jo edhe konstatimin e cenimit të së drejtës së jetës për shkak të moskryerjes së hetimeve efektive nga ana e organit të prokurorisë. Rrjedhimisht, gjykatat e zakonshme penale dhe veçanërisht Gjykata e Lartë mund të merrte në shqyrtim vetëm objektin e kërimit të lidhur me procesin penal dhe eventualisht të vendoste prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta, nëse do të mund të urdhërohej njëkohësisht edhe vazhdimi i hetimeve, ose mospranimin e rekurseve të paraqitura kundër tyre, nëse mundësia e vazhimit të hetimeve do të ishte e pamundur. Në fakt, çështja e paraqitur për zgjidhje përpara gjykatave të zakonshme nuk lidhej me pushimin e hetimeve ose pezullimin e tyre për shkak të pamundësisë së zbulimit të autorëve të vrasjes së ndodhur në Greqi më 21.9.1996, por me pushimin e procedimit penal për shkak të veprimit të institutit të parashkrimit të ndjekjes penale, i cili pamundëson objektivisht vijimin e hetimeve, sido që të jenë zhvilluar më parë ato (efektive ose joefektive). Konkretisht, neni 66 i KP-së, ashtu siç ka qenë në fuqi më 21.9.1996, parashikonte shprehimisht se: “Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar: a) njëzet vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë.”. Nga ana tjetër, paragrafi i fundit i nenit 3 të KP-së parashikonte se “Kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale”.

5. Argumentet e kërkuueseve në lidhje me kualifikimin e qëllimshëm të veprës penale nga prokuroria, si e parashikuar nga neni 76 i KP-së (dhe jo një kualifikim më i rëndë, për shkak se

vrasja është kryer me paramendim), nuk ndikojnë aspak te detyrimi i organit procedues për zbatimin e nenit 66 të KP-së, për sa kohë që, sipas ligjit të zbatueshëm, nuk bëhet fjalë dhe as nuk pretendohet për ekzistencën e krimeve të luftës ose të atyre kundër njerëzimit, për të cilat vepron përjashtimi nga zbatimi i institutit të parashkrimit të ndjekjes penale sipas nenit 67 të këtij kodi. Rrjedhimisht, vrasja e të ndjerit në vitin 1996, sido që të kualifikohej (sipas neneve 76, 78 ose 79 të KP-së), nuk mund të ndikonte në veprimin e afatit ligjor 20-vjeçar të parashkrimit të ndjekjes penale. Kjo në çdo rrethanë do të duhej të passillte pushimin e procedimit penal sipas nenit 328 të KPP-së, duke mos pasur mundësi prokuroria për të vijuar hetimin e çështjes.

6. Për sa i përket pretendimit të cenimit të së drejtës për jetën (në aspektin procedural) për shkak të moshetimit efektiv nga prokuroria, pakica vëren se ky kërkim, për sa kohë që në mënyrë të padyshimtë gjente zbatim neni 66 i KP-së (parashkrimi i ndjekjes penale), nuk mund të zgjidhej më në këtë proces penal dhe se çdo konstatim në këtë drejtim, në pjesën arsyetuese të vendimeve të gjykatave, nuk do të përbënte ndonjë vendim në favor të kërkueseve (përfshirë dhe në kuptim të nenit 70 të KPP-së). Pretendimet e kërkueseve për zhvillimin e hetimit në raport me aspektin procedural të së drejtës për jetën do të duhej të trajtoheshin nga gjykatat nëse do të ekzistonte mundësia e urdhërimit të zhvillimit të hetimeve efektive për mbrojtjen e së drejtës për jetën, por jo në rastin kur kryerja e mëtejshme e hetimeve është e ndaluar me një normë publike me karakter absolut, si ajo e parashikuar nga neni 66 i KP-së. Ndaj, në kushtet e çështjes objekt gjykimi, prishja e vendimit penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimi i çështjes për rigjykim nuk duket se rivendos në vend ndonjë të drejtë kushtetuese të kërkueseve, për shkak edhe të pamundësisë procedurale të disponimit me vendim nga ajo gjykatë për ndonjë zgjidhje efektive për garantimin e së drejtës për jetën, që pretendohet se është cenuar ose nxitjen e hetimit efektiv të rastit.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Genti Ibrahim, Asim Vokshi